

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Korriku sjell rekord vizitorësh në hotele, sa ishte rritja krahasuar me një vit më parë - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/korriku-sjell-rekord-vizitoresh-ne-hotele-sa-ishte-rritja-krahasuar-me-nje-vit-me-pare/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 16:57:31 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 16:54:44 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1293414fed1226143e46d6176b80343c162e5209633b18e4c3ff9235c384c782
TEKSTI	ba90b169a9ccaa787f3f8e7b905a4ec879fc217b4ac978fbd398dc2e65692287
PAMJA	4f7c2932e1f1f70c76fe05dbd3d9fa179432eeeb174c1282fb00eb6dff68887f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ff8b824c7271941412d3793152d45769c456979f0b559cf1404d6eec50b4d76d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	565d15129a3a8f2c33135848c08d2b7db1d78c2d7a3d3b93f84b73cbde96b20f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ff8b824c7271941412d3793152d45769c456979f0b559cf1404d6eec50b4d76d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Gjyqi i UÇK Protesta në Tiranë Turqi Kuvendi i Shqipërisë Turizmi në Shqipëri

EKONOMI | LAJMI I FUNDIT

Korriku sjell rekord vizitorësh në hotele, sa ishte rritja krahasuar me një vit më parë

17 Shtator 2026 | 18:54

Sezoni turistik i verës ka rritur aktivitetin e strukturave akomoduese në Shqipëri, me rreth 817 000 vizitorë të regjistruar vetëm gjatë muajit korrik. Të dhënat tregojnë se numri i vizitorëve që qëndruan në hotele dhe struktura të tjera akomoduese u rrit me 15% krahasuar me korrikun e një viti më parë.

Pjesa dërmuese e rritjes ka ardhur nga turistët e huaj. Numri i vizitorëve jo-rezidentë arriti në 622 700, kundrejt 526 300 një vit më parë, ose 18.3% më shumë. Vizitorët rezidentë u rritën me një ritëm më të moderuar, prej 6.4%, duke arritur në 194 000 persona.

Rritja e turizmit po reflektohet jo vetëm në numrin e personave të akomoduar, por edhe në net-qëndrime. Në korrik, numri i net-qëndrimeve u rrit me 14% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Për vizitorët e huaj rritja ishte 17%, ndërsa për rezidentët 4.4%.

Një tjetër tregues i rëndësishëm për industrinë hoteliere është norma e shfrytëzimit të dhomave. Në korrik 2026, ajo arriti në 55%, nga 53% në korrik të vitit të kaluar, duke u rritur me 2.4 pikë përqindjeje. Kjo tregon një përdorim më të lartë të kapaciteteve hoteliere në kulmin e sezonit turistik.

Kosova vazhdon të jetë tregu kryesor i origjinës për vizitorët e huaj që përdorin strukturat akomoduese në Shqipëri. Në korrik, turistët nga Kosova përbënin 18% të vizitorëve të huaj, të ndjekur nga Italia me 13% dhe Polonia me 11%. Franca zinte 7% dhe Gjermania 6%, ndërsa 45% e vizitorëve vinin nga vende të tjera.

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

EKONOMI | LAJMI I FUNDIT | VENDI

"Arbitrazhi rrëzon kërkesat e VIA-s", MIE: Hyn në fuqi zgjidhja e kontratës për Aeroportin e Vlorës

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka njoftuar se Arbitrazhi i Emergjencës ka rrëzuar kërkesat kryesore të VIA-s, koncesionarit të

LAJMI I FUNDIT

18:52 Studimi i ri: Moti i ftohtë mund të paralajmërojë rritjen e rasteve të arrestit kardiak

18:40 "ADHD rrit me 48% gjasat për probleme gastrointestinale", çfarë zbuluan studiuesit

18:38 Zgjidhet misteri 1600-vjeçar, ministri turk konfirmon ekzistencën e një tuneli 9 kilometra të gjatë nën Shën

SHPËRNDARJA
ARTIKULLIN

18:20 Milan në krizë, Cardinale telefonon Amorimin

18:17 Një tërmet i fortë godet Alaskën, sa ishte magnituda

18:10 Thaçi reagon pas vendimit në Hagë: Mohoj çdo përfshirje në vrasje, do ta apeloj vendimin

TESTIM

Aeroportit të Vlorës, dhe nuk ka...

17:43 | 17/09/2026

EKONOMI | SOCIALE | VENDI

ABI Bank konsolidon rritjen në gjashtëmuorin e parë 2026

Zgjerimi i shpejtë i rrjetit të degëve, likuiditeti i lartë dhe forcimi i kapitalit dëshmojnë zhvillimin e qëndrueshëm të Bankës. Banka Amerikane e Investimeve ka...

16:27 | 16/09/2026

EKONOMI

Prestigjiozja evropiane Euractiv vë në fokus bankungun digjital shqiptar

Zhvillimet në sektorin financiar shqiptar janë bërë pjesë e analizës së medias evropiane Euractiv, e cila ka ndalur te transformimi digjital i bankungut dhe potenciali...

12:47 | 16/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni
Punësimi

Follow Euronews on all platforms: